



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA SUHAREKË  
ZYRA E PROKURIMIT

13.07.2020

|                                                                                                                                       |                         |                               |                            |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|-------------------------------|----------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS<br>REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA<br>REPUBLIC OF KOSOVO - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA |                         |                               |                            |
| MARRE NË DORËZIM                                                                                                                      |                         | PRIMIJE                       | RECEIVED                   |
| Nësa org.<br>Org. Jedinica<br>Org. Unit                                                                                               | Numri<br>Broj<br>Number | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Vlera<br>Vrednost<br>Value |
| CA                                                                                                                                    | 351                     | 29137                         | 2                          |

KOMUNA SUHAREKË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), te cilën e përfaqëson Mustafë Buzhala zyrtar i zyres se prokurimit dhe menaxheri i kontratës i caktuar me Aktvendim nga ZKA<sup>1</sup> dhe ne PMK<sup>2</sup> nga njësia e kërkesës, në njërën anë dhe:

PBC SH.P.K., Rr.Idriz Gjilani p.n., 10000, Prishtinave seli në Prishtinë me NUI 810845985 të cilën e përfaqëson Bashkim Selmani, ne anën tjetër janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

**Titulli i kontratës**

Mirëmbajtja e E-kioskave dhe avancimi i programit- Qertifikata e pronës  
Nr.prokurimit: 624-20-2133-2-3-6/624-020-048-236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Mirëmbajtja e E-kioskave dhe avancimi i programit- Qertifikata e pronës**, sipas specifikimit të detyrueshëm të dhëna me dosje të tenderit me kuotim të çmimeve.

1.2 Kontrata është një vjeçare (1) dhe hynë në fuqi me: **13/07/2020 dhe përfundon me 12/07/2021.**

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 2 ore nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimit është në Suharekë sipas kërkesës së njësisë/drejtorisë.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>3</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.

<sup>1</sup> ZKA Zyrtari Kryesor Administrativ

<sup>2</sup> PMK Plan për Menaxhimin e Kontrates

<sup>3</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

#### Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **8.950,00 €( tetëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë euro.)**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

#### Neni 4 Pagesat

**4.1 Pagesa do të bëhet në Euro nga njësia e kërkesës . Autoriteti Kontraktues do të lejojë pagesat, ku operatori ekonomik duhet të sjellë faturën për kryerje të shërbimeve me raportin e nënshkruar nga mbikëqyesi dhe menaxheri i kontratës nga njësia e kërkesës në llogarinë bankare të OE:**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *shërbimeve* duhet të jetë gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### Neni 7 Garancioni

7.1 specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

## Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin: **të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet**/[te kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **shërbimeve** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë vendim nga gjykata kompetente në Kosovë.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën kompetente në pajtim me **ligjin e Kosovës**.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.


E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Telefoni: 038/600 -200

Email bashkim@pbc-ks.com

**Për Operatorin Ekonomik**

**Për Autoritetin Kontraktues**

|             |                                                                                     |             |                                                                                      |
|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------|--------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:       | Bashkim Selmani                                                                     | Emri:       | Mustafë Buzhala                                                                      |
| Pozita:     | Përfaqësues                                                                         | Pozita:     | Zyrtar i zyres së prokurimit                                                         |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 13/07/2019                                                                          | Data:       | 13/07/2019                                                                           |
| Vula:       | vv                                                                                  | Vula:       | vv                                                                                   |

| Nr.r | Përshkrimi Teknik                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Sasia | Çmimi  | Shuma  |
|------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|--------|--------|
|      | Pajisjet:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |       |        |        |
| 1    | Furnizimi, montimi, instalimi dhe leshimi ne pune i PC Industrial Brand Name - Industrial Mainboard: CPU Min i3; RAM: Min 8 GB; HDD: min 120 GB; dhe porti i nevojshëm për lidhje periferike me eKioskë.                                                                                                                                                                                     | 1     | 450.00 | 450.00 |
| 2    | Furnizimi, montimi, instalimi dhe leshimi ne pune i 17" Touch Screen (Rezistent ndaj ujit, High Transparence, High Precision and Durability; Ports:USBantirust, anti-acid, anti-dust, Operating temperature : -20 / +50oC;)                                                                                                                                                                  | 1     | 550.00 | 550.00 |
| 3    | Furnizimi, montimi, instalimi dhe leshimi ne pune i Printer bardh e zi - Kërkesat minimale: Deri në 30 ppm A4, 250 sheets + 500 sheets tray, 6 seconds, Deri në 1200 x 1200 dpi rezolucioni i printimit, 512 MB Memorie dhe 520MHz CPU                                                                                                                                                       | 1     | 325.00 | 325.00 |
| 4    | Furnizimi, montimi, instalimi dhe leshimi ne pune i Thermal Printer, Letra (in-depth) 80mm, Dots/line:640 dots/line; Rezolucioni: 8; Print Speed: 150mm/s, Automaticcutter; Print width: 72 mm; Paper width: 80 mm; Thickness of paper: 56-150 µm; WxDxH (mm): Head temperature detection: Thermistor; Paper running out alarm; Paper to be run out alarm, Paper jam alarm; Interface:Serial | 1     | 295.00 | 295.00 |
| 5    | Furnizimi, montimi, instalimi dhe leshimi ne pune i SmartCoinDispenser, Coin Acceptor and Payout speed: 12 coins/s Support: euro coins 0.10, 0.20, 0.30, 0.50, 1:00, 2:00 Interfaced: USB Coin dimensions: Diameter: 18~28.5mm, Thickdss:1.65~3.2mm MCBE                                                                                                                                     | 1     | 750.00 | 750.00 |

|   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |   |               |          |
|---|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|---------------|----------|
| 6 | Furnizimi, montimi, instalimi dhe leshimi ne pune i ID-Document Scanner, Skaneri duhet të skanojë të dy llojet e dokumenteve të identifikimit që aplikohen në Kosovë: skanimi i imazhit të dokumentit të identifikimit, leximi i dokumentit të identifikimit, , dizajn për të mbrojtur dritën e diellit | 1 | 550.00        | 550.00   |
| 7 | Furnizimi, montimi, instalimi dhe leshimi ne pune i Kameres se integruar e sigurisë, E jashtme 360 Night Vision Camera: IR Distance 10m, CMOS Sensor, Waterproof, 5MP                                                                                                                                   | 1 | 95.00         | 95.00    |
| 9 | Furnizimi, montimi, instalimi dhe leshimi ne pune i UPS, 1250 wat.                                                                                                                                                                                                                                      | 1 | 85.00         | 85.00    |
|   | <b>Shërbimet:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                       |   |               |          |
| 1 | Zhvillimi dhe implementimi i moduleve shtese (certifikata e pronës)                                                                                                                                                                                                                                     | 1 | 3,750.00      | 3,750.00 |
| 2 | Mirëmbajtja për 12 muaj                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 1 | 2,100.00      | 2,100.00 |
|   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |   | <b>Totali</b> | 8,950.00 |